

VENDIM
Nr. 431, datë 15.5.2013

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS
KATUNDI I RI TË QARKUT TË DURRËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Katundi i Ri të qarkut të Durrësit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 64 (gjashtëdhjetë e katër) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 350 (treqind e pesëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Katundi i Ri për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Katundi i Ri, Durrës

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-11	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
12-15	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore dhe sportive	Në përdorim
16-21	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
22-31	Varrezat publike	Në pronësi
32-42	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
43-210,228,236-250,253-259,349,350	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
211-227,229-235,245-246,251-252	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
279	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim Sip. 29.35 arë, në fshatin Rinia është “tokë disponibël shtet”, përfshirë në masterplanin për zhvillimin e integruar të Zonës Energjetike dhe Industriale të Porto-Romanos, Durrës miratuar nga KRRTSH-ja
280-285,290,296,301,305 (vetëm kanale të treta)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
321-325	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi